

Majko e shokë, të procedohen?!

[Gazeta Shqiptare, 3.3.2006]

Dëgjuam se si sekretari i PS-së, z. Pandeli Majko, deklaroi publikisht e me mburrje, se kishte pasë urdhëruar kryeprokurorin, z. Rakipi, që mos të vazhdonte procedimet ligjore në ngarkim të qytetarit Sali Ramë Berisha. Kjo, kur ky i fundit ishte kryetar në opozitë i PD-së, dhe z. Majko ishte kryeministër. Prokuroria paskësh hapur një dosje për “puçin e rrëzimit të qeverisë në vitin 1998”, ku përgjegjësi kryesorë e paskësh pasur deputeti Sali Ramë Berisha, të cilit i ishte pasë hequr imuniteti, prandaj edhe prokuroria ishte e lirë të procedonte (vepronte) kundër tij. Rilexua Kushtetutën e sa e sa ligje të tjera, duke u përpjekur të gjenim se në cilin ligj e kishte bazuar ndërhyrjen e vet mbi prokurorinë, kryeministri socialist i kohës, dhe nuk e gjetëm dot, bile përkundrazi, gjetëm ndalimin ligjor që kryeministri të ndërhyjë në punën e prokurorisë, e cila “funksionon pranë sistemit gjyqësor”, pra nuk është fare në varsi të kryeministrit. Na rezulton se është shkelur ligji, e prandaj arrijmë automatikisht 5 konkluzione tronditëse.

1—Z. Majko, kryeministri i kohës, i bie se duhet të merret në përgjegjësi penale për krimin e “kanosjes së gjyqtarit (apo prokurorit)” (neni 317 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë), sepse i është kanosur prokurorit të përgjithshëm, duke e detyruar të ndërpresë procedimin penal ndaj të kallëzuarit Berisha—ku ka kanosje më të madhe se mund t’i bëhet një prokurori, se sa ajo e një kryeministri që të thotë “mos e bëj”! Prandaj, pas deklaratës së tij, z. Majko i bie se duhet t’ia kalojë dikujt tjetër atë “bilbilin e mbrojtjes së votës së lirë”, atë që po na pëlqen ta dëgjojmë si kauzë të drejtë, të zbatimit të kushtetutës, por që moralisht nuk i takon t’i bjerë një njeriu që e pranon vetë, bile me mburrje, se e shkel Kushtetutën.

2—Z. Rakipi, kryeprokurori i kohës, i bie se duhet të merret në përgjegjësi penale për krimin e “kërkimit apo marrjes së shpërblimit” (neni 319 i KP), sepse është joshur nga kryeministri i kohës, për të mos kryer veprimin që lidhej me funksionin e tij si prokuror: procedimin sipas ligjit për të kallëzuarin për puç, deputetin Berisha—ku ka përfitim e premtim më të mirë se sa ai që të jep një kryeministër! Në Kushtetutën tonë, në nenin 148, pika 3, shkruhet: “Në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve.”—nuk shkruhet se i binden kryeministrit!

3—PS, për 8 vjet në pushtet, i bie se ka ngritur institucione të kompromiseve joligjore me partinë simotër, me PD-në. I bie se po vëtetohen akuzat mediatike, se dy partitë e mëdha shqiptare bëjnë sikur grinden, u “bien bilbilave” apo ulurasin me “dukët e krimin”, por në prapaskenë, me marrëveshje direkte ose në heshtje, ndajnë pushtetin në kundërshtim me ligjin, dhe natyrisht në dëm të shqiptarëve. Kur PS është në pushtet, godet ku i duhet e vetëm sa i duhet, krimin e PD-së; kurse kur PD është në pushtet, ia kthen favoret në të njëjtën mënyrë: godet ku i duhet dhe vetëm sa i duhet.

4—Kryeministri aktual, z. Berisha, i bie se paska të drejtë kur çirret duke uluritur se “prokuroria fle mbi dosjet e krimin”, sepse vërtetë kjo prokurori, edhe me kryetarin e ri z. Sallaku, nuk paskësh rihapur dosjen e të kallëzuarit Sali Ramë Berisha, e po kështu edhe të sa e sa të tjerëve, të gjitha të “futura nën jastëk”. Prokuroria i bie se duhet t’i kishte rihapur urgjentisht dosjet e mbyllura, duke filluar me ato të politikanëve më kryesorë.

5—Presidenti i Republikës, z. Moisiu, i bie se duhet të iniciojë një procedim penal, kundër prokurorisë aktuale, duke filluar nga kryeprokurori aktual. Ky procedim i bie se duhet të kryhet nga një “prokurori e prokurorisë”, nga një institucion, apo grup institucionesh, apo nga një komision

hetimor parlamentar, që të verifikohen akuzat e bëra nga politika, qoftë ndaj apatisë së prokurorisë, qoftë në lidhjet e saj me krimin, qoftë në akuzat e favorizimit të saj ndaj personave me funksione politike, qoftë në fjetje mbi dosjet e krimit etj..

Nuk dëshmohet bazimi në ligj, me thirrjet patetike “për moralin”, “për Kosovën”, “për tolerancën”, “për konsensusin”, “për të mirën e kombit shqiptar” etj, sepse të gjitha këto janë thjeshtë sofizma: nuk ka asnjë të mirë për askënd në kombin shqiptar, nëse shkelet ligji; gjëja më e nevojshme që ka kombi ynë është të mësojë të respektojë e të zbatojë ligjin; kur ligji është i gabuar, duhet ta ndërrojë, apo ta shfuqizojë urgjentisht, e jo të bëjë zgjidhje “alla shqiptarçe”: të mos e zbatojë!

Bashkim Kopliku

Durrës, më 2.3.2006